



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 727/3 prot.

Tiranë, më 05 .07 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 125 , datë 05 . 07 . 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, është paraqitur ankesa nr. 127 Regj., datë 19.06.2023, e shtetasit V. N, kundër ish-Drejtuesit të ish-Zyrës Arsimore Kolonjë, me pretendim diskriminimin për shkak të “*bindjeve politike*”<sup>2</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se subjekti ankues, është me profesion arsimtar dhe ka punuar për rreth 32 vite mësues pranë ish-Zyrës Arsimore (ZA) Kolonjë.

Për periudhën 14 prill 2014-fund gushti 2016, ankuesi ka mbajtur detyrën e drejtorit në Shkollën e Mesme të Bashkuar (SHMB) “Jani Vreto” Leskovik, pranë ZA Kolonjë.

Ai shprehet se: “*Më kanë larguar nga detyra për shkak të një konflikti që pata me përgjegjësin e ZA të asaj kohe, lidhur me edukatoren E. K, kushërirë e tij, për të cilën edhe u penalizova padrejtësisht dhe me një tendencë të paparë, me qëllim të mbështetjes së nepotizmit. Ky person*

<sup>1</sup> Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

<sup>2</sup> Bindjeve politike të baxhanakut, kandidat për kryetar të Bashkisë Leskovik 2015, si kandidaturë e propozuar nga PS.

*më ka vënë në fokus të hakmarrjes së tij për shkak të bindjeve politike të djathta të demonstruara nga ana e tij, konflikti i cili rezultoi me shkarkimin tim si drejtor në mënyrë të padrejtë.*

*Në mënyrë të përmbledhur rrethanat e ngjarjes janë si më poshtë:  
Nga viti 1986-2011 kam punuar si mësues në ZA Kolonjë.*

*2011-2014 jam larguar nga puna si mësues dhe më kanë lënë pa punë fare, për shkak se baxhanaku im S. P, kandidoi për Kryetar Bashkie në Leskovik, i propozuar nga Partia Socialiste (PS) në kohën që pushtetin qendror dhe lokal në Leskovik në atë periudhë e kishte PD.*

*Me 14.04.2014, u emërova drejtor i SHMB “Jani Vreto” Leskovik. Dy mësues ngritën pretendimin se ky pozicion i takonte mësueses D. K.*

*Në muajt korrik-gusht 2016, ZA Kolonjë shpalli konkursin për drejtor të kësaj shkolle dhe në përfundim të procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të SHMB, ankuesi nuk ka rezultuar fitues dhe e ka kontestuar atë”.*

Në shpjegimet e detajuara që ankuesi bën lidhur me emërimin e D. K si drejtoreshë e SHMB-së, dhe procedurës së ndjekur, ai vë theksin në faktin se ajo pavarësisht se nuk zotëron diplomën e duhur për të ushtruar profesionin e mësuesit, jo vetëm vazhdon të jetë mësuese, por është edhe drejtoreshë në SHMB Leskovik, dhe kjo vetëm për faktin se është kryetare e PS Leskovik.

Ankuesi ka parashtruar pretendimin tjetër, lidhur me edukatoren E. K, e cila, në kohën kur ai ishte drejtor i SHMB Leskovik, ka bërë kallëzim penal kundrejt tij dhe është ankuar tek emisioni “Fiks Fare” duke pretenduar se ai e ka larguar nga puna pa të drejtë, konflikti i cili është nënshtruar gjyqësit gjyqësor në vijim.

Lidhur me këtë konflikt, ankuesi pretendon se është larguar pa të drejtë nga puna, duke u penalizuar nga ana e ish-përgjegjës të ZA Kolonjë, të asaj kohe, i cili është edhe kushëriri i punonjës/edukatoreshë në fjalë.

Pretendimet që burojnë nga ky konflikt i gjeneruar mes palëve, janë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor (referuar Vendimit të Gjykatës me nr. 75, datë 31.08.2015, cituar prej ankuesit).

Ankuesi citon se: *“Pavarësisht situatës së krijuar me edukatoren E. K, pavarësisht se ajo ishte në dijeni të favoreve nepotike që po i bënte kushëriri i saj, përgjegjësi S. D, sërish pati guximin që në paligjshëminë e tyre të thërrisnin gazetarët e emisionit “Fiks Fare”, të cilët u kthyen në noterizues të veprimeve të tyre të paligjshme, ku pa kontrolluar asgjë ligjërisht, bazuar vetëm në relacione fjalësh përfituan shikueshmëri në kurrizin tim.*

*Gjithashtu në këtë emision është prononcuar edhe ish- përgjegjësi i ZA Kolonjë, S. D, i cili nuk ka treguar në emision që është kushëri me edukatoren që i është drejtuar emisionit, nuk ka referuar shkeljet e tyre me qëllim për të favorizuar kushërirën e tij, por me paturpësinë më të madhe është prononcuar duke thënë se ne do të shohim veprimet e këtij drejtori, pa i treguar gazetarëve që shkelësit e vërtetë të ligjit, ishin ata që pretendonin shkeljen.*

*Lidhur me këtë, gjithashtu ankuesja e cila ka bërë denoncimin, ka bërë edhe kallëzim penal për mua, duke më akuzuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”.*

*Lidhur me këtë akuzë, që nga viti 2015 janë zhvilluar hetime e gjykime të pafundme, duke analizuar se janë kryer hetim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, gjykim në Gjykatën e Apelit Korçë, si dhe rekurs në Gjykatën e Lartë, ku gjykata me të drejtë ka vendosur pushimin e gjykimit duke nxjerrë kallëzimin për shpërdorim detyre si të padrejtë.*

*E gjithë kjo histori e vërtetë, tashmë është zbardhur me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe unë duke iu referuar edhe vendimit si pikënisje e afatit për të bërë ankimimin tek KMD, po i drejtohem Komisionerit për diskriminimin që më është bërë, dhe kjo vetëm për të mbrojtur bindjet partiake si dhe mbështetësit partiak të njërit apo tjetrit krah, duke marrë vendime të paqenësishme, në kundërshtim të plotë me ligjin, duke futur e nxjerrë persona nga puna, jo sipas ligjit, por thjesht duke menduar se partia të jep pushtetin dhe e ke dorën e lirë të vendosësh këdo në punë e të shkarkosh këdo që i ke vënë syrin nga puna.*

*Reputacioni im si drejtor shkolle dhe si punonjës në arsim u nëpërkëmb nga disa njerëz që nuk njohin asnjë parim tjetër përveçse ngjyrave politike dhe haptaz e demonstrativisht, në shkelje flagrante të ligjit, vendosen drejtorë për shkak të bindjeve politike, një zonjë që ishte e pamundur me diplomën që kishte të ishte pjesë e strukturave mësimdhënëse, ndërsa mua, më sulmuan për shkak të baxhanakut, i cili kandidoi për një forcë politike të kundërt me bindjet e tyre.*

*Në lidhje me këtë odise, kam përjetuar një sërë peripecish, të cilat më kanë dëmtuar rëndë reputacionin tim, jetën personale dhe private, shoqërore e familjare”.*

Bazuar në deklaratimet e provat e depozituara nga ankuesi, rezulton se personi me të cilin krahasohet ai, është drejtorja e SHMB Leskovik, D. K, zgjedhur në këtë detyrë në vitin shkollor 2019-2020, dhe të gjitha paligjshmëritë e pretenduara lidhur me përzgjedhjen e emërimit e saj në këtë detyrë, për të cilin pretendon se është tërësisht politik, lidhen me këtë periudhë kohore.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe

*mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit se, vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shërbejë si indicie lidhur me kërkimin e tij për diskriminim, pasi nëse ai do ta kërkonte më parë këtë gjë, do të ishte i paragjykuar për shkak të rrethanave në të cilat u vendos nga personat e tjerë.*

Bazuar në aktet e depozituara nga subjekti ankues, bashkëlidhur ankesës, rezulton se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 448, datë 19.09.2016, ka vendosur:  
*“Deklarimin fajtor të të pandehurit V. N për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) muaj burgim.*

*Bazuar në nenin 35, të Kodit Penal, ndaj të pandehurit V. N, të caktohet si dënim plotësues heqja e të drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë 1 (një) vjeçare”.*

Kundër këtij vendimi, subjekti ankues ka paraqitur ankimim dhe, lidhur me sa më sipër,

- Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 56, datë 01.03.2017, ka vendosur:  
*“Prishjen e vendimit nr.448, datë 29.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit V. N”.*

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit Korçë, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit penal nr. 56, datë 01.03.2017, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 448, datë 29.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Kundër rekursit të Prokurorisë ka paraqitur kundër-rekurs i gjykuari V. N.

Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 257, datë 16.02.2023, ka disponuar lidhur me mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë, kundër vendimit nr. 56, datë 01.03.2017, të Gjykatës së Apelit Korçë.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankuesit se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë shërben si provë e re për rivendosjen e së drejtës së tij në kohë, dhe se ai nuk mund të pretendonte diskriminimin më përpara për shkak se në atë kohë të gjithë do ta paragjyonin atë për shkak të rrethanave, nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara ligjërisht për arsyet e mëposhtme:*

*Së pari, kundërshtimi i ankuesit dhe kërkimi i tij para Komisionerit, lidhet me pretendimin për paligjshmërinë e kryer në procedurën për largimin e tij dhe emërimin e drejtores së SHMB “Jani Vreto” Leskovik, nga ana e ZA Kolonjë, emërim i bërë në vitin 2019. Parë në këtë këndvështrim, Komisioneri vëren se, çdo pretendim i ankuesit lidhur me këtë moment, duhet të paraqitet pranë KMD-së, në afatet ligjore të parashikuara në LMD.*

Që në momentin e largimit nga puna, ankuesi nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që në çdo kohë, brenda afateve ligjore t’i drejtohej Komisionerit me ankesë në lidhje me pretendimet e tij për akte, veprime apo sjellje diskriminuese të ZA Kolonjë apo drejtuesve të saj ndaj tij.

Referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se:

*“Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”.*

Kërkimi i ankuesit lidhur me këtë fakt, është paraqitur pranë KMD-së me datë 19.06.2023, pra rreth 4 (katër) vite pas emërimit të D. K si drejtores e SHMB “Jani Vreto” Leskovik (në vitin 2019).

Së dyti, çështja penale kundër ankuesit ka nisur për shpërdorim detyre, mbi bazën e kallëzimit të shtetasës E. K, të cilën ankuesi e kishte larguar nga puna si edukatore. Fakti që ankuesi ka qenë në procedim penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës nuk ka përbërë pengesë ligjore që ai të depozitonte ankesën për diskriminim pranë KMD-së.

Fusha e veprimtarisë, objekti e kompetencat e organeve të drejtësisë dhe të KMD-së, janë të ndryshme. Në rastin konkret, nëse pretendimi i ankuesit për diskriminim do të kishte jo vetëm lidhje të drejtëpërdrejtë me procedimin penal ndaj ankuesit, por edhe se kjo ankesë nuk mund të zgjidhej pa përfunduar gjykimi penal (me vendim të formës së prerë) për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, atëherë do të ishte Komisioneri që do ta vlerësonte këtë fakt, dhe do të pezullonte shqyrtimin e ankesës deri në zgjidhjen e çështjes penale.

Edhe nëse realisht ushtrimi i ankimimit do të ishte i ndërlidhur me çështjen penale, kjo e fundit është zgjidhur me vendim të formës së prerë të gjykatës që në vitin 2017.

Marrja dijëni e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, datë 16.02.2023, në muajin shkurt 2023, nuk mund të legjitimojë ankuesin për të rivendosur në afat kërkimin e tij pranë KMD-së, pasi, edhe nëse ankuesi do e lidhte pretendimin e tij për diskriminim nga ana e ish-përgjegjësit të ZA Kolonjë me përfundimin e procesit të tij penal (apo faktet e tjera të pretenduara si ato të paraqitura në emisionin “Fiks Fare”, me qëllim denigrimin e figurës së tij) sërish ai daton në 01.03.2017, që është data e vendimit të shpallur nga Gjykata e Apelit Korçë, datë që përkon me momentin e marrjes së vendimit formë të prerë si dhe njëherësh të marrjes dijëni nga ankuesi për të, dhe rrjedhimisht ky moment është përtej afatit ligjor të parashikuar në LMD, për shqyrtimin e tij. *(Pasi ankesa pranë KMD-së është regjistruar me datë 19.06.2023).*

Për më tepër, nëse ankuesi do të pretendonte në kërkimin e tij lidhur me një fakt, rrethanë a provë e cila do të ishte e lidhur direkt apo indirekt me disponimin e gjykatës respektive, ai, në kontekst të detyrimit për zbatueshmërinë e tij, do të duhej t'i referohej një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe jo domosdoshmërisht një vendimi përfundimtar (siç është vendimi i Gjykatës së Lartë).

- Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi, rezulton se, vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë, daton me 01.03.2017, vendim ky i formës së prerë. Për rrjedhojë ankuesit çdo pretendim për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë i lind nga marrja dijëni e tij, që daton po në vitin 2017 (mars 2017).

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

*“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm”.*

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.*

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t’i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrohet veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet vendimmarrjes së çështjes konkrete. Asnjë pushtet apo organ tjetër nuk mund të veprojë si gjykatë dhe të marrë kompetencat e saj.

Bazuar në sa më sipër dhe dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, evidentohet se ankuesi e ka ezauruar rekursin e brendshëm gjyqësor, sa i takon shpalljes së tij i pafajshëm lidhur me akuzën për veprën penale.

Komisioneri vëren se, referuar vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit dhe janë të detyrueshme për zbatim nga personat fizikë e juridikë, të cilëve iu drejtohen.

Ankuesi ka marrë dijeni për vendimin e formës së prerë, të Gjykatës së Apelit Korçë, që në muajin mars 2017, vendim i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë organet të cilave u drejtohet.

Në këtë vendim, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetur se:

*“... siç shihet i pandehuri V. N ka marrë disa masa disiplinore dhe gjithçka është trajtuar si kundërvajtje administrative. Masat administrative të marra ndaj të pandehurit, si fillim pezullim nga puna dhe në fund kthimin në detyrë si drejtor i SHMB “Jani Vreto” Leskovik, tregojnë se dhe i pandehuri ka qenë në të drejtën e tij si drejtor i Shkollës, pavarësisht se nga personat e tretë (ZA Kolonjë, Avokati i Popullit dhe Minsitia e Arsimit) që janë marrë me këtë çështje, kanë preluar interesat e shtetases E. K që është konsideruar në periudhë mbrojtjeje (paslindje), sipas Kodit të Punës. Gjykata e Apelit, për sa u analizua më sipër, arrin në përfundimin se në rastin në gjykim jemi përpara shkeljeve administrative të shkaktuara nga i pandehuri V. N i ndikuar dhe nga veprimet mospërfillëse të shtetases E. K si punëmarrëse (edukatore) ndaj tij në cilësinë e punëdhënësit (drejtorit të SHMB “Jani Vreto” Leskovik)”.*

Bazuar në sa më sipër, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i datës 16.02.2023, nuk mund të legjitimojë ankuesin për të rivendosur në afat kërkimin e tij, përse i takon pretendimit për diskriminim në kuadër të liritimit dhe mosëmërimit të tij në detyrën e drejtorit të SHMB “Jani Vreto” Leskovik, pasi këto ngjarje kanë ndodhur rreth 4 (katër) vite para se ankuesi të paraqiste ankesën pranë KMD-së (regjistruar me datë 19.06.2023).

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit V. N, (edhe në rast se do të duhet t’i referohej një vendimi gjyqësor të formës së prerë) nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



Kur një e drejtë (e drejta për t'ju drejtuar Komisionerit) nuk ushtrohet në afatin e caktuar ligjor, atëherë individi ka humbur të drejtën që pretendimet e tij të shqyrtohen në themel, nga Komisionerit, kjo edhe në respektim të parimit të sigurisë juridike.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues V. N, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**